



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori k. Salih Mustafës

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 19 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së dytë për ecurinë e çështjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bóné

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenin 39(1), (5) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 92(2)(c) dhe 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin në vijim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi “Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës”,² “Fletarrestim për z. Salih Mustafa”³ dhe “Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara”.⁴
2. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.⁵

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version konfidencial i redaktuar dhe një version publik i redaktuar të këtij vendimi u protokolluan më 5 tetor 2020.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Version i redaktuar publik i fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Version i redaktuar publik i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e parashtrimit të versionit publik të redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publike).

3. Më 24 shtator 2020, Salih Mustafa (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”) u arrestua⁶ dhe transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁷
4. Më 28 shtator 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi “Urdhër për parashtrime në lidhje me sistemin e redaktimit”.⁸
5. Të njëjtën ditë, z. Mustafa pati paraqitjen e tij të parë dhe, ndër të tjera, refuzoi të vetëdeklarohej në lidhje me fajësinë ose pafajësinë në atë kohë.⁹
6. Më 30 shtator 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi urdhër për mbajtjen e konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes në lidhje me nxjerrjen e provave dhe tema lidhur me to dhe, për këtë qëllim, i bashkëlidhi urdhrin një listë të temave për diskutim.¹⁰
7. Më 1 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi për protokollim parashtrimet e saj lidhur me sistemin e redaktimit.¹¹
8. Më 5 tetor 2020, të dy palët dorëzuan parashtrime me shkrim përpara konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes.¹² Po atë ditë u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.¹³ Për sa i përket caktimit të datës për seancën e vetëdeklarimit në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe për konferencën vijuese

⁶ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, *Njoftim i pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00022, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për parashtrime mbi sistemin e redaktimit*, 28 shtator 2020, publik.

⁹ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 28 shtator 2020, publik, f. 11, rreshtat 24-25.

¹⁰ KSC-BC-2020-05, F00023, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër mbi caktimin e datës për konferencë mbi ecurinë e çështjes*, 30 shtator 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

¹¹ KSC-BC-2020-05, F00024, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit*, 1 tetor 2020, publik.

¹² KSC-BC-2020-05, F00029, Mbrojtja, *Parashtrimet e Mbrojtjes për konferencën mbi ecurinë e çështjes të datës 5 tetor 2020*, 5 tetor 2020, publike; KSC-BC-2020-05, F00030, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes*, 5 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një version i redaktuar publik i parashtrimeve të ZPS-së u protokollua të njëjtën ditë.

¹³ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 5 tetor 2020, f. 19-46, publik, f. 47-50, konfidencial dhe *ex parte*.

mbi ecurinë e çështjes, mbrojtësi i z. Mustafa shprehu parapëlqimin që seancat të mos mbaheshin në datat 15 dhe 20 tetor 2020.¹⁴

9. Më 9 tetor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi “Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse”, në të cilin përcaktohet një sistem për nxjerrjen e provave, i vlefshëm deri në janar 2021.¹⁵

10. Më 12 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti kërkesë për masa mbrojtëse lidhur me materiale në lidhje me pesë dëshmitarë.¹⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në bazë të rregullës 92(2)(b) të Rregullores, i akuzuari mund të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm për çdo akuzë, ose në paraqitjen e tij të parë ose brenda 30 ditësh prej mbajtjes së saj. Sipas rregullës 92(2)(f) të Rregullores, në qoftë se gjatë paraqitjes së parë ose paraqitjeve vijuese i akuzuari nuk vetëdeklarohej në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, gjykatësi i procedurës paraprake bën deklarimin në emër të të akuzuarit se i akuzuari është i pafajshëm.

12. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, pas konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, gjykatësi i procedurës paraprake mbledh konferenca vijuese mbi ecurinë e çështjes gjyqësore për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, për të garantuar përgatitje të shpejta për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes,

¹⁴ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 5 tetor 2020, publik, f. 45, rreshti 25 deri f. 46, rreshti 2.

¹⁵ KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse*, 9 tetor 2020, publik.

¹⁶ KSC-BC-2020-05, F00035, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për masa mbrojtëse*, 12 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një version konfidencial i redaktuar i parashtrimeve të ZPS-së u protokollua më 12 tetor 2020. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00036, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim plotësues i kërkesës për masa mbrojtëse*, 13 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen.

13. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizime rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në pajtim me rregullën 102(3), ZPS-ja i jep Mbrojtjes njoftim të detajuar për çdo material dhe provë që ka në posedim.

14. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë: (i) dosjen e vet paraprake, e cila ndër të tjera përmban çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes dhe një listë të pikave të pakontestuar: (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e këtyre provave.

15. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi, dhe gabime faktike ose ligjore.

16. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesën e të akuzuarit dhe me praninë e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

III. DISKUTIM

17. Duke marrë parasysh parapëlqimin e Mbrojtjes, dhe mbi bazën e afatit kohor të përcaktuar në rregullën 92(2)(c) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake thërret një seancë gjyqësore ditën e mërkurë, 28 tetor 2020, në orën 15:00.

18. Gjatë pjesës së parë të seancës, zotit Mustafa do t'i kërkohet të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm për akuzat e paraqitura kundër tij në Aktakuzën e Konfirmuar, në pajtim me rregullën 92(2)(c) të Rregullores. Nëse i akuzuari refuzon ta bëjë këtë, gjykatësi i procedurës paraprake bën deklarimin në emër të të akuzuarit se është i pafajshëm në bazë të rregullës 92(2)(f) të Rregullores.

19. Pjesa e dytë e seancës do të shërbejë si konferencë e dytë mbi ecurinë e kësaj çështjeje gjyqësore. Gjykatësi i procedurës paraprake do t'u kërkojë palëve të japin përditësime lidhur me problemet ende të pazgjidhura që u përvijuan në rendin e ditës të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, si dhe mbi parashtrimet me shkrim ose me gojë të bëra nga palët deri më tani. Në veçanti dhe përveç sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake do të kërkojë përditësime lidhur me sa vijon:

- a. Nëse palët kanë hasur ndonjë vështirësi në lidhje me nxjerrjen e materialit provues;
- b. Nëse ZPS-ja i ka përfunduar hetimet që ishte ende duke i kryer ose nëse mund të jepet një datë e përafërt për përfundimin e tyre;
- c. Vlerësimi i ZPS-së se kur do të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen e vet paraprake dhe materialin në lidhje me të në pajtim me rregullën 95(4)(a)-(c) të Rregullores, në bazë të kalendarit për nxjerrjen e provave të përcaktuar në vendimin kornizë mbi nxjerrjen e provave;
- d. Bazuar në vlerësimin e ZPS-së për pikën më lart dhe të procesit në vijimësi të nxjerrjes së materialeve (që është planifikuar të vazhdojë deri në janar 2021), nëse Mbrojtja është në gjendje të japë më shumë informacion

për: (i) ecurinë e hetimeve të saj; (ii) synimin për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësi në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, dhe për nxjerrje të materialit përkatës në pajtim me rregullën 104(1) dhe (2) të Rregullores; dhe (iii) synimin për të bërë kërkesa lidhur me mundësitë hetimore të vetme, në pajtim me rregullën 99(1) të Rregullores.

20. Së fundi, palëve do t'u kërkohet të japin mendimet e tyre lidhur me datën e një konference të tretë mbi ecurinë e kësaj çështjeje.

21. Palët ftohen që deri të martën 27 tetor 2020, të dorëzojnë, nëse dëshirojnë, parashtrime me shkrim mbi cilëndo nga temat e mësipërme, përfshirë edhe për temat e diskutuara në konferencën e parë për ecurinë e çështjes, ose çfarëdo teme tjetër që nuk është përfshirë në rendin e ditës së konferencës së dytë për ecurinë e çështjes, apo për çfarëdo vështirësie të hasur lidhur me nxjerrjen e materialit provues.

IV. VENDIM

22. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **VENDOS** të thërrasë një seancë gjyqësore me praninë e ZPS-së dhe të Mbrojtjes, ditën e **mërkurë, 28 tetor 2020, në orën 15:00;**
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë deri ditën e **martë, 27 tetor 2020**, sikurse përcaktohet në paragrafin 21.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i procedurës paraprake

E hënë, 19 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.